



Pranuar / Dorezuar Prenjeno / Predato Received / Delivery	11. 01. 2024	viti god Year	2024
Organ Njësia Organ / Jednitca Org / Unit	Rr / Prot Rr / Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMNBHCK	218/2024		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1468/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1468/2023, të datës 01.12.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit KD.nr.040/2022, të datës 16.01.2023, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridiko-administrative “kundërshtim i masës disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi, 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1468/2023, e datës 01.12.2023 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Mbetet në fuqi** pika dy (2) e dispozitivit të Vendimit KD.nr.040/2022, të datës 16.01.202, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi Arsim (tutje ankuesi), më datë 01.12.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.040/2022, të datës 16.01.2023, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.12.2013 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës, ndaras, ky i fundit, më datë 14.12.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushtet lidhur me pranueshmërinë e ankesës sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7154/2023 të datës 01.12.2023, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 040 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.998/2022 të Këshillit; Vendimin KD.nr.040/2022 të datës 16.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Zarfën e datës 29.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 14.12.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar për ankuesin Arsim Krasniqi e datës 02.07.2018; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 03.01.2020; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 27.09.2022; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 13.01.2023; Vendimin e datës 12.07.2022 për ndryshimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 13.10.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 11.02.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e intervistimit të ankuesit nga ana e Komisionit Disiplinor i datës 06.10.2022; Urdhëresë për sjellje e datës 29.08.2022; Emailin e datës 26.09.2022 nga R.B për Sh.K; Emailin nga M.A për S.G, I.D dhe Sh.K; Emailin e datës 26.09.2023 nga M.A për B.G; Emailin e datës 23.09.2022, 26.09.2022 nga B.G për M.A.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe së i njëjti sipas Kontratës së Punës, të datës 30.06.2018, është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar Korrektues*, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 28.09.2022, Udhëheqësi i Njësitit për Përcjelljen e të Burgosurve ka paraqitur kërkesë për iniciim të procedurës disiplinore ndaj katër (4)zyrtarëve, përfshirë ankuesin, për shkak të supozimit së të njëjtit me datë 23.09.2022, kanë qenë të obliguar të zbatojnë Urdhëresën me numër 8340/2022 të datës 23.09.2022 për përcjellje të burgosurve nga qendra e Paraburgimit në Prizren në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, dhe së pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe dorëzimit të të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, kanë qenë dashur të kthehen me kohë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për të vazhduar punën deri në fund të orarit dhe duke marr parasysh intervalin kohor prej dorëzimit të të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe kthimin e tyre në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, dyshohet se ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrтарët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës më Vendimin me numër protokolli 040 të datë 26.10.2022, ka shpallur zyrtarët përgjegjës veç e veç për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrтарët Publikë, duke shqiptuar ndaj zyrtarëve veç e veç masën disiplinore *“ndalimi i 20% e pagës për periudhën një (1) muaj”*.

Zyrtarët në këtë rast edhe ankuesi, me datë 11.11.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 040 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.998/2022 të datës 23.12.2023, ka aprovuar ankesën e ankuesve, duke anuluar Vendimin me numër protokolli 040 të datës 26.10.2022, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i SHKK-së.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës në riprocedurë me Vendimin KD.nr.040/2022 të datës 16.01.2023, përkatësisht në pikën 2 të dispozitivit ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke shqiptuar masën disiplinore *“ndalimi i 20% e pagës për periudhën një (1) muaj”*.

Ankuesi kundër Vendimit KD.nr.040/2022 të datës 16.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës të cilin e ka pranuar më datë 30.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se Komisioni Disiplinor nuk ka marr parasysh vërejtjet e dhëna nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike sepse e kemi pasur të pamundur të shfrytëzojmë pushimin ditor kështu që në kuptim të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës kemi bërë pushimin gjatë kthimit nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan. Kërkon që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën dhe të anuloj Vendimin KD.nr.040/2022 të datës 16.01.2023, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i aplikueshëm në kohën e zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, me theks të veçantë:

Nenin 45: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*.

Nenin 46: *“shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin*

apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë” ndërsa “Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”.

Nenin 47 paragrafi 1: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenin 50: “1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin e goditur me ankesës në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka vlerësuar së Vendimi KD.nr.040/2022 i datës 16.01.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues, është nxjerrë mbi bazën e vërtetimit të plotë të gjendjes faktike si dhe në zbatim të drejtë të dispozitave materiale, për faktin së nga shkresat e lëndës dhe vet deklaratës së ankuesit pranë Komisionit Disiplinor, Kolegji ka gjetur së ankuesi se bashku me zyrtaret korrektues [redacted] dhe [redacted] kanë qenë të caktuar në zbatim të urdhërues gjyqësore numër 8340/22, të datës 23.09.2022, rrejdhimisht për bartjen e të burgosurit A.S nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe së të njëjtit pas përfundimit të orarit zyrtar, gjegjësisht kthimi i tyre nga QP në Gjilan për në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ka qenë në kohëzgjatje rreth 4 orëve nga 16:00 deri 20:00 pasi që të njëjtit ishin ndaluar për të ngrënë tek lokali “kometa” në dalje të Suharekës, dhe së për këtë ndalesë dhe vonesë nuk kishin njoftuar udhëheqësin e tyre, kështu që, mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji konstaton së Komisioni Disiplinor ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46, paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe në këtë mënyrë ka shqiptuar masën disiplinore në pajtim me nenin 50 paragrafin 4 të këtij ligji.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë vëren se i njëjti ju referohet pesë (5) zyrtarëve korrektues, ku të gjithë janë shpallur përgjegjës veç e veç duke ju shqiptuar masat disiplinore veç e veç, kështu që refuzimi i ankesës A.nr.1468/2023 dhe shfuqizim i Vendimit KD.nr.040/2022, të datës 16.01.202, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka të bëjë vetëm me pikën dy (2) të dispozitivit të këtij vendimi.

Theksuar si me lart, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm

mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1468/2023

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.